



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR TREPÇËN<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON TREPÇA<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKONA O TREPČI<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Trepçën ,është miratuar në mbledhjen e 111 të Qeverisë së Republikës së Kosovës , me vendimin Nr.02/111, datë 05.10.2016

<sup>2</sup> Draft Law on Trepça ,was approved in the 111 meeting of the Government of Republic of Kosovo, with the decision No.02/111, dt. 05.10.2016

<sup>3</sup> Nacrt zakona o Trepči ,usvojenje na 111 sednicu Vlade Republike Kosova , odlukom Br. 02/111, datum 05.10.2016

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p style="text-align: center;"><b>LIGJ PËR TREPÇËN</b></p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b><br/><b>Qëllimi</b></p> <p>Ky ligj ka për qëllim krijimin e infrastrukturës ligjore e cila synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik përmes hapjes së rrugës për investime, rritjen e vlerës së asetëve dhe avancimin e kapitalit tekniko teknologjik si parakusht për rivitalizimin e Trepçës, jetike për mirëqenien sociale të punëtorëve dhe interesin e përgjithshëm publik.</p> | <p>The Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Approves:</p> <p style="text-align: center;"><b>LAW ON TREPÇA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER I - GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b><br/><b>Purpose</b></p> <p>The purpose of this law is to establish the legal infrastructure which aims to ensure a sustainable economic development, through opening way for investments, enhancing the value of assets and advancing the technical-technological capital as a prerequisite for the revitalization of Trepça, which is vital for the social wellbeing of its employees and the general public interest.</p> | <p>Skupština Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p style="text-align: center;"><b>ZAKON O TREPČI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE I - OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1</b><br/><b>Cilj</b></p> <p>Cilj ovog zakona je uspostavljanje zakonske infrastrukture koja ima za cilj održivi ekonomski razvoj kroz utiranje puta za investicije, povećanje vrednosti sredstava i unapređenje tehničko-tehnološkog kapitala kao preduslova za razvoj Trepče, što je od vitalnog značaja za socijalno blagostanje radnika i opšti javni interes.</p> |
|--|--|---|

|  |  |  |
|--|--|--|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 2<br/>Fushëveprimi</b></p> <p>1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë transformimin e njërive biznesore të listuara në paragrafin 2 të këtij neni në Shoqëri Aksionare Trepça Sh.A.</p> <p>2. Njësitë biznesore të Trepça Sh.A janë:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89);</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88);</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. Minierat me Flotacion Kopaonik - Lepasaviç (Fi 804/89);</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 2<br/>Scope</b></p> <p>1. Provisions of this law determine the transformation of the organization of business units listed in paragraph 2 of this Article into a joint stock company – Trepça JSC.</p> <p>2. Business units of Trepça JSC are:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Mines and floatation Trepça-Stan Tërg (Fi 690/89);</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. Mines and floatation Kishnicë and Artanë (Fi 690/89);</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. Mines and Floatation Kopaonik – Lepasaviç (Fi 804/89);</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 2<br/>Delokrug</b></p> <p>1. Odredbe ovog zakona utvrđuju transformaciju poslovnih jedinica nabrojanih u stavu 2 ovog člana u Akcionarsko društvo Trepča AD.</p> <p>2. Poslovne jedinice Trepče AD su:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. Rudnici sa flotacijom Trepča-Stari Trg (Fi 690/89);</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. Rudnici sa flotacijom Kišnica i Novo Brdo (Fi 349/88);</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. Rudnici sa flotacijom Kopaonik-Lepasavić (Fi 804/89);</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 3<br/>Përkufizimet</b></p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. <b>“Trepça”</b> - nënkupton Ndërmarrjen Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila është e regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia për Regjistrim të</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Article 3<br/>Definitions</b></p> <p>1. Expressions used in this law shall have the following meaning:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. <b>“Trepça”</b>– means the Socially Owned Enterprise under administration of the Kosovo Privatization Agency, which is registered in the registry of the Kosovo Business Registration Agency - Ministry of Trade and Industry, with business</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 3<br/>Definicije</b></p> <p>1. Pojmovi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeće značenje:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. <b>“Trepča”</b>- je društveno preduzeće pod upravom Kosovske agencije za privatizaciju, koje je upisano u registru Ministarstva trgovine i industrije - Kosovska</p>  |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>Biznesit në Kosovë, me numër të regjistrimit të biznesit 70331094 si dhe e regjistruar në regjistrat gjyqësorë me emërtimin: Kombinati Xehetaro-Metalurgjik Kimik Trepça, e cila aktualisht e bazuar në certifikatën e regjistrimit identifikohet me emërtimin “Trepça – Ndërmarrje në Administrim të AKP”;</p> <p>1.2. <b>Njësi biznesore</b> - nënkupton njësitë biznesore të Trepçës, siç janë përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji;</p> <p>1.3. <b>Legjislacioni relevant</b> - përfshin në mënyrë specifike, por pa u kufizuar, Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet publike (Gazeta Zyrtare, nr. 31, 15 qershor 2008), si dhe Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare, nr. 39, 1 tetor 2008).</p> <p>1.4. <b>Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)</b> - nënkupton organin e pavarur publik, i themeluar me ligj, e cila është e autorizuar për administrimin e ndërmarrjeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare, nr. 19 / 21 shtator</p> | <p>registration number 70331094, and registered in court registries under the name: Mining-Metallurgic and Chemical Combine “Trepça”, which based on its current registration certificate is identified under the name “Trepça – Enterprise under PAK Administration”;</p> <p>1.2. <b>Business unit</b> – means Trepça’s business units, as defined in Article 2 of this law;</p> <p>1.3. <b>Relevant legislation</b> – includes in specific, but not limited to, Law No. 03/L-087 on Publicly Owned Enterprises (Official Gazette No. 31, of 15 June 2008), and Law No. 02/L-123 on Trade Associations (Official Gazette No. 38, of 1 October 2008).</p> <p>1.4. <b>Kosovo Privatization Agency (KPA)</b> – means the public independent body established by law, which is authorized to administer enterprises defined in Law No. 04/L-034 on Kosovo Privatization Agency (Official Gazette No. 19, of 21 September 2011), as amended and supplemented with respective laws;</p> | <p>agencija za registraciju biznisa, pod registarskim brojem poslovnog subjekta 70331094 i upisano u sudskim registrima pod nazivom: Rudarsko-metalurško hemijski kombinat Trepča, a koje se trenutno na osnovu potvrde o registraciji identifikuje pod nazivom “Trepča – Preduzeće pod upravom KAP”;</p> <p>1.2. <b>Poslovne jedinice</b> - su poslovne jedinice Trepče, utvrđene u članu 2. ovog člana;</p> <p>1.3. <b>Relevantno zakonodavstvo</b> - obuhvata posebno, bez ograničenja, Zakon br. 03/L-087 o javnim preduzećima (Službeni list, br. 31, 15. jun 2008. godine) i Zakon br. 02/L-123 o trgovačkim društvima (Službeni list, br. 39, 1. oktobar 2008. godine),</p> <p>1.4. <b>Kosovska agencija za privatizaciju (KAP)</b> - je nezavisni javni organ, osnovan zakonom, koji je ovlašćen za upravljanje preduzećima utvrđenim u Zakonu br. 04/L-034 o Kosovskoj agenciji za privatizaciju (Službeni list, br. 19 / 21. septembar 2011. godine), izmenjenom i dopunjenom relevantnim zakonima;</p> |
|--|--|---|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>2011) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet përkatëse;</p> <p>1.5. <b>Ministria</b> - nënkupton Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, apo ministrinë pasuese që ka kompetenca për ndërmarrjet publike;</p> <p>1.6. <b>Dhoma e Posaçme</b> - nënkupton Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë e Privatizimit, e themeluar në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 22 shtator 2011);</p> <p>1.7. <b>Partneriteti Publiko Privat ose PPP</b> - nënkupton çdo bashkëpunim kontraktues ose institucional në mes të një ose më shumë Autoriteteve Publike dhe një ose më shumë Partnerëve Privatë siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat (Gazeta Zyrtare, nr. 26 / 25 nëntor 2011).</p> | <p>1.5. <b>Ministry</b> – means the Ministry of Economic Development, or a subsequent ministry competent for publicly-owned enterprises;</p> <p>1.6. <b>Special Chamber</b> – means the Special Chamber of the Supreme Court for Kosovo Privatization Agency Related Matters, established in line with Law No. 04/L-033 on the Special Chamber of the Supreme Court for Kosovo Privatization Agency Related Matters (Official Gazette No. 20, 22 September 2011);</p> <p>1.7. <b>Public-Private Partnerships or PPPs</b> – means any contractual or institutional cooperation between one or more Public Authorities and one or more Private Partners, as defined in Law No. 04/L-045 on Public-Private Partnerships (Official Gazette No. 26, of 25 November 2011);</p> | <p>1.5. <b>Ministarstvo</b> – je Ministarstvo ekonomskog razvoja, odnosno ministarstvo sledbenik koje ima nadležnost za javna preduzeća;</p> <p>1.6. <b>Posebna komora</b> - je Posebna komora Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju, osnovana u skladu sa Zakonom br. 04/L-033 o Posebnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju (Službeni list, br. 20, 22. septembar 2011. godine);</p> <p>1.7. <b>Javno-privatno partnerstvo ili JPP</b> - je svaka ugovorna ili institucionalna saradnja između jednog ili više javnih autoriteta i jednog ili više privatnih partnera, na način propisan u Zakonu br. 04/L-045 o javno-privatnom partnerstvu (Službeni list, br. 26 / 25. novembar 2011. godine);</p> |
|--|--|---|

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 4<br/>Aksionarët</b></p> <p>1. Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 80% të aksioneve të Trepça Sh.A.</p> <p>2. Pronarë të 20% të aksioneve të Trepça Sh.A. janë punëtorët.</p> <p>3. Përqindja e pjesëmarrjes në 20% të aksioneve, për secilin punëtor veç e veç, përcaktohet duke e përlogaritur sipas vlerës së asetëve të njësishë biznesore ku punëtori ka marrëdhënie pune.</p> <p>4. Aksionar në 20% të aksioneve nga radhët e punëtorëve në njësishë biznesore mund të jetë vetëm punëtori në marrëdhënie të rregullt pune që është në listën e pagave në njësishë përkatëse biznesore jo më pak se 3 vite nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 4<br/>Shareholders</b></p> <p>1. The Government of the Republic of Kosovo shall own 80% of Trepça JSC shares.</p> <p>2. Trepça JSC employees shall own 20% of the shares.</p> <p>3. The percentage of participation in the 20% of shares shall be determined for each employee individually, based on the value of assets of the business unit in which the employee has established an employment relation.</p> <p>4. Only an employee with a regular working relation, who has been in the payroll of the respective business unit for no less than three years from the date of entry into force of this law shall be eligible to be a shareholder in the 20% of shares owned by employees of business units.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 4<br/>Akcioniari</b></p> <p>1. Vlada Republike Kosovo je vlasnik 80% akcija Trepče AD.</p> <p>2. Vlasnici 20% akcija Trepče AD su radnici.</p> <p>3. Procenat udela u 20% akcija za svakog radnika zasebno, utvrđuje se njegovim obračunom prema vrednosti sredstava poslovne jedinice u kojoj je radnik u radnom odnosu.</p> <p>4. Akcionar u 20% akcija iz redova radnika u poslovnoj jedinici može biti samo radnik u redovnom radnom odnosu koji se nalazi na platnom spisku u odgovarajućoj poslovnoj jedinici najmanje 3 godine od dana stupanja na snagu ovog zakona.</p> |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 5<br/>Resurset Minerale, bartja e pasurisë, të drejtave dhe burimeve njerëzore</b></p> <p>1. Resurset Minerale janë pronë e Republikës së Kosovës.</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 5<br/>Mining resources, transfer of assets, rights and human resources</b></p> <p>1. Mineral resources shall be property of the Republic of Kosovo.</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Član 5<br/>Mineralni resursi, prenos imovine, prava i ljudskih resursa</b></p> <p>1. Mineralni resursi su vlasništvo Republike Kosovo.</p>  |

|  |  |   |
|--|--|---|
| <p>2.Trepça Sh.A. hulumton dhe shfrytëzon resurset minerale në bazë të licencës për hulumtim dhe shfrytëzim të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.</p> <p>3.Të gjitha të drejtat, interesat dhe licencat e vlefshme operuese të Ndërmarrjes Shoqërore Trepça kalojnë në Trepça Sh.A.</p> <p>4.Të gjithë punëtorët të cilët kanë kontratë të rregullt pune në njësinë biznesore të definuar me këtë ligj, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë marrëdhënien e punës në njësinë përkatëse biznesore.</p> | <p>2. Trepça JSC shall explore and exploit mineral resources based on a license for exploration and exploitation issued in accordance with the legislation in power in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. All rights, interests and valid operational licenses of the Socially Owned Enterprise Trepça shall be transferred to Trepça JSC</p> <p>4. All employees with a regular employment contract with a business unit defined in this law shall continue their employment relation with the respective business unit from the date of entry into force of this law.</p> | <p>2. Trepča AD istražuje i eksploatiše mineralne resurse na osnovu licence za istraživanje i eksploataciju izdate u skladu sa važećim propisima u Republici Kosovo.</p> <p>3. Sva prava, interesi i važeće licence za rad Društvenog preduzeća Trepča prenose se na Trepča AD.</p> <p>4. Svi radnici koji imaju redovni ugovor o radu u poslovnoj jedinici definisanoj ovim zakonom na dan stupanja na snagu ovog zakona nastavljaju radni odnos u odgovarajućoj poslovnoj jedinici.</p> |
| <p><b>KAPITULLI II - ORGANIZIMI DHE REGJISTRIMI</b></p>  | <p><b>CHAPTER II - ORGANIZATION AND REGISTRATION</b></p>   | <p><b>POGLAVLJE II - ORGANIZACIJA I REGISTRACIJA</b></p>  |
| <p><b>Neni 6<br/>Statuti</b></p>   | <p><b>Article 6<br/>Statute</b></p>  | <p><b>Član 6.<br/>Statut</b></p>  |
| <p>1. Struktura organizative, kapitali themeltar, menaxhimi dhe çështjet tjera organizative specifike të Trepça Sh.A, përcaktohen në statutin e shoqërisë aksionare sipas legjislacionit relevant në fuqi.</p>   | <p>1. The organizational structure, initial capital, management and other organizational specifics of Trepça JSC shall be determined in the statute of the joint stock company, in accordance with the relevant applicable legislation.</p>  | <p>1. Organizaciona struktura, osnivački kapital, upravljanje i druga specifična organizaciona pitanja Trepče AD, utvrđuju se u statutu akcionarskog društva u skladu sa relevantnim važećim propisima.</p>   |

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p>2. Statuti i Trepça Sh.A hartohet nga Bordi Mbikëqyrës dhe miratohet nga aksionarët.</p> <p>3. Asetet e Trepça Sh.A. përbëhen nga asetet e njësive biznese të përcaktuara me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet në statut, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit dhe me metodat standarde të vlerësimit.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7<br/>Regjistrimi</b></p> <p>Ministria, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për regjistrimin në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.</p> <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI III - QEVERISJA</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b></p> <p>1. Qeverisja e Trepça Sh.A. bëhet nga:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Bordi Mbikëqyrës;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Bordi Menaxhues.</p> | <p>2. The Statute of Trepça JSC shall be drafted by the Oversight Board and adopted by the shareholders.</p> <p>3. Assets of Trepça JSC consist of assets of business units established by this law, and their value is determined in the statute, based on the feasibility study and standard valuation methods.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7<br/>Registration</b></p> <p>The Ministry, on behalf of the Government of the Republic of Kosovo, shall undertake all legal actions required for the registration in the Business Registration Agency in the Ministry of Trade and Industry.</p> <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER III - GOVERNANCE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 8</b></p> <p>1. Governance of Trepça JSC shall be conducted by the:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Oversight Board;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Managing Board.</p> | <p>2. Statut Trepçe AD izrađuje Nadzorni odbor, a usvajaju ga akcionari.</p> <p>3. Sredstva Trepçe AD se sastoje od sredstava poslovnih jedinica utvrđenih ovim zakonom, a njihova vrednost se utvrđuje u statutu na osnovu studije o izvodljivosti i standardnih metoda za vrednovanje.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7<br/>Registracija</b></p> <p>Ministarstvo će, u ime Vlade Republike Kosovo, preduzeti sve pravne radnje za registraciju u Agenciji za Registraciju Biznisa pri Ministarstvu trgovine i industrije.</p> <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE III - UPRAVLJANJE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 8</b></p> <p>1. Trepčom AD upravljaju:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Nadzorni odbor;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Upravni odbor.</p> |
|---|---|--|



| <p align="center"><b>Neni 9</b><br/><b>Bordi Mbikëqyrës</b></p>   | <p align="center"><b>Article 9</b><br/><b>Oversight Board</b></p>   | <p align="center"><b>Član 9</b><br/><b>Nadzorni odbor</b></p>   |
|---|---|---|
| <p>1. Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. përbëhet nga nëntë (9) anëtarë të zgjedhur nga aksionarët përpjesëtimisht me pjesëmarrjen në kapital, sipas procedurave që përcaktohen në statut.</p> <p>2. Zgjedhja e Bordit Mbikëqyrës të Trepça Sh.A. bëhet sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për Ndërmarrjet Publike në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Në përbërjen e Bordit Mbikëqyrës duhet të sigurohet ekspertiza e nevojshme nga fusha e ekonomisë, drejtësisë, teknike dhe teknologjike si dhe kërkesa specifike të përkufizuara me Statutin e Trepça Sh.A.</p> <p>4. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës duhet të kenë diplomë universitare nga fushat e cekura në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të kenë përvojë pune së paku 10 vjeçare, prej të cilave 5 vite në pozita menaxhuese.</p> <p>5. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të forumeve të partive politike dhe as të kenë konflikt interesi sipas dispozitave të Ligjit mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit, si</p> | <p>1. The Oversight Board of Trepça JSC shall consist of nine (9) members elected by the shareholders in proportion to their participation in the capital, and in accordance with the procedures set in the Statute.</p> <p>2. Selection of the Oversight Board of Trepça JSC shall be done in accordance to procedures established by the applicable legislation on Publicly Owned Enterprises in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. The composition of the Oversight Board shall ensure the necessary expertise in the economic, legal, technical and technological fields, as well as specific requirements as defined by the Statute of Trepça JSC.</p> <p>4. Members of the Oversight Board must have university degrees from the areas as stated in paragraph 3 of this Article, must have experience of at least 10 years, of which 5 years in managerial positions.</p> <p>5. Members of the Oversight Board cannot be members of political party forums or have a conflict of interest as per the provisions of the Law on the Prevention of Conflicts of Interest,</p> | <p>1. Nadzorni odbor Trepče AD se sastoji od devet (9) članova izabranih od strane akcionara srazmerno udelu u kapitalu, a u skladu sa procedurama utvrđenim u statutu.</p> <p>2. Izbor Nadzornog odbora Trepče AD sprovodi se u skladu sa procedurama utvrđenim važećim propisima o javnim preduzećima u Republici Kosovo.</p> <p>3. U sastavu Nadzornog odbora se mora osigurati potrebna ekspertiza iz oblasti ekonomije, prava, tehničko-tehnološke oblasti, kao i specifični zahtevi definisani Statutom Trepče AD.</p> <p>4. Članovi Nadzornog odbora moraju imati univerzitetsku diplomu iz oblasti navedenih u stavu 3 ovog člana, i moraju imati radno iskustvo od najmanje 10 godina od kojih 5 godina radnog iskustva na rukovodećim pozicijama.</p> <p>5. Članovi Nadzornog odbora ne smeju biti članovi foruma političkih stranaka, niti biti u sukobu interesa shodno odredbama Zakona o sprečavanju sukoba interesa, i moraju ispunjavati ostale</p> |

|  |   |   |
|--|---|---|
| <p>dhe duhet t'i plotësojnë kriteret e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</p> <p>6. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës janë të pavarur në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre dhe mandati i tyre zgjat katër (4) vite.</p> <p>7. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës mund të shkarkohen nga aksionarët që përfaqësojnë, sipas dispozitave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës.</p> <p>8. Bordi Mbikëqyrës, përveç kompetencave dhe autorizimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike në Republikën e Kosovës, ushtron edhe këto detyra dhe përgjegjësi:</p> <p>8.1. Zgjedh anëtarët e Bordit Menaxhues të Trepça Sh.A.;</p> <p>8.2. Aprovon planet financiare dhe zhvillimore të njësive biznesore në kuadër të Trepça Sh.A.;</p> <p>8.3. Aprovon kontratat lidhur me partneritetin.</p> | <p>and must fulfill other requirements as established by the legislation in force.</p> <p>6. Oversight Board members are independent in the exercise of their duties and responsibilities and their mandate is four (4) years.</p> <p>7. Members of the Oversight Board may be dismissed by the representing shareholders, in accordance to the provisions laid down by the applicable legislation on publicly owned enterprises in Kosovo.</p> <p>8. In addition to the powers and authorizations established in the applicable legislation on Publicly Owned Enterprises in the Republic of Kosovo, the Oversight Board shall also exercise the following duties and responsibilities:</p> <p>8.1. Selection of the members of the Managing Board of Trepça JSC;</p> <p>8.2. Approval of financial and development plans of business units under Trepça JSC;</p> <p>8.3. Approval of contracts related to joint ventures and investments.</p> | <p>kriterijume utvrđene važećim zakonodavstvom.</p> <p>6. Članovi Nadzornog odbora su nezavisni u vršenju svojih dužnosti i odgovornosti, a njihov mandat traje četiri (4) godine.</p> <p>7. Članovi Nadzornog odbora mogu biti razrešeni od strane akcionara koje zastupaju, u skladu sa odredbama utvrđenim važećim propisima o javnim preduzećima u Republici Kosovo.</p> <p>8. Nadzorni odbor, osim nadležnosti i ovlašćenja utvrđenih u važećim propisima o javnim preduzećima u Republici Kosovo, obavlja i sledeće dužnosti i odgovornosti:</p> <p>8.1. Bira članove Upravnog odbora Trepče AD.;</p> <p>8.2. Usvaja finansijske i razvojne planove poslovnih jedinica u okviru Trepče AD.;</p> <p>8.3. Usvaja ugovore koji se odnose na partnerstvo.</p> |
|--|---|---|

|   |  |  |
|---|--|--|
| <p>9. Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, transformimin dhe shuarjen e njësive biznesore ose investimet në projekte të reja, Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë pëlqimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionari kryesor.</p> <p>10. Në punën e vet Bordi Mbikëqyrës udhëhiqet nga parimet e qeverisjes korporative të transparencës, llogaridhënies, efikasitetit dhe efektivitetit, kompetencës profesionale dhe pavarësisë.</p> <p>11. Bordi Mbikëqyrës mund të themelojë komitete/komisione të përhershme ose të përkohshme nga kompetenca dhe fushëveprimtaria e vet, përfshirë komitetin/komisionin e Auditimit të Brendshëm.</p> <p>12. Krahas kësaj Bordi Mbikëqyrës do të angazhojë një auditor të jashtëm të pavarur me reputacion ndërkombëtar i cili do të raportojë tek aksionarët lidhur me pasqyrat financiare të njësive biznesore të Trepça Sh.A.</p> | <p>9. The Oversight Board must obtain the consent of the Government of the Republic of Kosovo, as the majority shareholder, on issues related to the establishment, transformation or abolition of business units, or investment in new projects.</p> <p>10. In its operations, the Oversight Board shall adhere to corporate governance principles of transparency, accountability, efficiency and effectiveness, professional competence and independence.</p> <p>11. The Oversight Board may establish permanent or temporary committees/commissions as per its powers and scope, including an Internal Audit committee/commission.</p> <p>12. In addition, the Oversight Board shall engage an internationally-renowned independent external auditor who will report to the shareholders on the financial statements of Trepça JSC business units.</p> | <p>9. Po pitanjima koja se odnose na osnivanje, transformaciju i gašenje poslovnih jedinica ili investicije u nove projekte, Nadzorni odbor mora dobiti saglasnost Vlade Republike Kosovo kao glavnog akcionara.</p> <p>10. Nadzorni odbor se u svom radu rukovodi principima korporativnog upravljanja, transparentnosti, odgovornosti, efikasnosti i efektivnosti, profesionalne stručnosti i nezavisnosti.</p> <p>11. Nadzorni odbor može osnovati stalne ili privremene odbore/komisije iz svoje nadležnosti i delokruga rada, uključujući i odbor/komisiju za internu reviziju.</p> <p>12. Pored toga, Nadzorni odbor će angažovati i nezavisnog eksternog revizora sa međunarodnom reputacijom, koji će izveštavati akcionare u vezi sa finansijskim izveštajima poslovnih jedinica Trepče AD.</p> |
|---|--|--|

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b><br/><b>Bordi Menaxhues</b></p> <p>1. Bordi Menaxhues, përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv i Trepça Sh.A., Zëvendësi i tij, ndihmësit e tij dhe udhëheqësit e njësive biznesore.</p> <p>2. Mënyra e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Menaxhues përcaktohen me Statutin e Trepça Sh.A.</p>  | <p style="text-align: center;"><b>Article 10</b><br/><b>Managing Board</b></p> <p>1. The Managing Board shall consist of the Chief Executive Officer of Trepça JSC, his/her deputy, assistants and heads of business units.</p> <p>2. The functions and powers of the Managing Board shall be defined in the Statute of Trepça JSC.</p>   | <p style="text-align: center;"><b>Član 10</b><br/><b>Upravni odbor</b></p> <p>1. Upravni odbor se sastoji od izvršnog direktora Trepče AD, njegovog zamenika, njegovih pomoćnika i rukovodilaca poslovnih jedinica.</p> <p>2. Način funkcionisanja i ovlašćenja Upravnog odbora utvrđuju se Statutom Trepče AD.</p>   |
| <p style="text-align: center;"><b>KAPITULLI IV - NJËSITË BIZNESORE</b></p>  | <p style="text-align: center;"><b>CHAPTER IV - BUSINESS UNITS</b></p>   | <p style="text-align: center;"><b>POGLAVLJE IV - POSLOVNE JEDINICE</b></p>  |
| <p style="text-align: center;"><b>Neni 11</b></p> <p>1. Bazuar në studimin e fizibilitetit dhe arsyeshmërinë ekonomike e financiare, në përbërje të Trepça Sh.A. formohen edhe këto njësi biznesore:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Metalurgjia e Plumbit;<br/>1.2. Metalurgjia e Zinkut;<br/>1.3. Industria Kimike.</p> <p>2. Bazuar në studimin e fizibilitetit mund të themelohen edhe njësi të tjera biznesore për përpunimin e metaleve, produkteve dhe shërbimeve të tjera.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Article 11</b></p> <p>1. According to a feasibility study and economic and financial reasoning, the following business units shall be established under the composition of Trepça JSC:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Lead Metallurgy – Zvečan;<br/>1.2. Zink Metallurgy Mitrovicë;<br/>1.3. Chemical industry – Mitrovicë.</p> <p>2. According to the feasibility study, other business units can be established for the processing of metals and other products and services.</p> | <p style="text-align: center;"><b>Član 11</b></p> <p>1. Na osnovu studije izvodljivosti i ekonomske i finansijske opravdanosti, u sastavu Trepče AD se osnivaju i sledeće poslovne jedinice:</p> <p style="margin-left: 40px;">1.1. Metalurgija olova;<br/>1.2. Metalurgija cinka;<br/>1.3. Hemijska industrija.</p> <p>2. Na osnovu studije izvodljivosti mogu se osnovati i druge poslovne jedinice za preradu metala i druge proizvode i usluge.</p> |

|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>3. Njësitë biznesore të Trepça Sh.A. formohen sipas këtij Ligji dhe sipas vendimeve të Bordit Mbikëqyrës me propozim të Bordit Menaxhues në bazë të studimit të fizibilitetit.</p> <p>4. Njësitë biznesore do të kenë nënlligari të veta evidentuese dhe kompetenca për të menaxhuar operacionet e veta dhe për të marrë vendime lidhur me pagat dhe shpenzimet operative sipas planeve financiare të aprovuara nga Bordi Mbikëqyrës.</p> <p>5. Njësitë biznesore mund të propozojnë planet, projektet investuese në të cilat do të mund të investojnë fitimin e tyre dhe inkuadrojnë iniciativa për partneritetin publiko-privat ose investuesve privatë me aprovim në Bordin Mbikëqyrës.</p> <p>6. Dividendi që u takon aksionarëve sipas pjesëmarrjes së tyre në aksione evidentohet dhe paguhet në nivel të njësisë biznesore duke u bazuar në rezultatin financiar të saj.</p> <p>7. Mënyra e funksionimit të njësisë biznesore rregullohet me Statutin e Trepça Sh.A.</p> | <p>3. Business units of Trepça JSC shall be established as per this Law and decisions of the Oversight Board, upon the proposal of the Managing Board and based on the feasibility study.</p> <p>4. Business units shall have their own recording sub-accounts and the powers to manage their operations and make decisions regarding the salaries and operational expenses as per the financial plans approved by the Oversight Board.</p> <p>5. Business Units may propose plans, investment projects in which they may invest their profits, and be involved in public-private partnership initiatives or with private investors, upon the approval of the Oversight Board.</p> <p>6. Dividends that the shareholders are entitled to, commensurate with their shares, shall be recorded and paid in the level of business units based on the financial outcome.</p> <p>7. Operations of business units shall be regulated by the Statute of Trepça JSC.</p> | <p>3. Poslovne jedinice Trepče AD se osnivaju u skladu sa ovim Zakonom i odlukama Nadzornog odbora na predlog Upravnog odbora zasnovano na studiji o izvodljivosti.</p> <p>4. Poslovne jedinice će imati svoje evidencione podračune i ovlašćenja za upravljanje svojim operacijama i donošenje odluka o platama i operativnim troškovima u skladu sa finansijskim planovima odobrenim od strane Nadzornog odbora.</p> <p>5. Poslovne jedinice mogu da predlažu planove i investicione projekte u koje mogu da investiraju svoj profit i uključe inicijative za javno-privatno partnerstvo ili privatne investitore uz odobrenje Nadzornog odbora.</p> <p>6. Dividenda koja pripada akcionarima na osnovu njihovog udela u akcijama, evidentira se i isplaćuje na nivou poslovne jedinice na osnovu njenog finansijskog rezultata.</p> <p>7. Način funkcionisanja poslovnih jedinica reguliše se Statutom Trepče AD.</p> |
|--|---|--|

| <b>KAPITULLI V - MUNDËSITË E PJESËMARRJES SË SEKTORIT PRIVAT</b>  | <b>CHAPTER V - PRIVATE SECTOR PARTICIPATION POSSIBILITIES</b>   | <b>POGLAVLJE V - MOGUĆNOSTI UČEŠĆA PRIVATNOG SEKTORA</b>   |
|---|---|--|
| <b>Neni 12</b>  | <b>Article 12</b>   | <b>Član 12</b>   |
| <p>1. Trepça Sh.A. në kuadër të procesit të transformimit dhe ristrukturimit me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e saj do të krijojë mundësi për të qenë atraktive për investues privatë vendorë dhe të jashtëm, në format si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1.1. partneriteti publiko-privat;</li> <li>1.2. investime direkte private;</li> <li>1.3. investime të përbashkëta;</li> <li>1.4. emetimi dhe shitja e aksioneve.</li> </ul> <p>2. Investimet në njësitë ekzistuese qeverisen sipas pjesëmarrjes në kapital.</p> <p>3. Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A. mund të vendosë aranzhmane kontraktuale për qeverisjen dhe menaxhimin në njësitë përkatëse biznese edhe kur pjesëmarrja e investitorit privat në kapital është më e vogël se 50%.</p> <p>4. Në rast se investitori privat krijon një pjesëmarrje më të madhe se 50% në njësinë</p> | <p>1. Trepça JSC, under the transformation and restructuring process, with the aim of creating the conditions for its development, will strive to be attractive to private investors, both domestic and foreign, in the form of:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1.1. public-private partnerships;</li> <li>1.2 direct private investments;</li> <li>1.3 joint investments;</li> <li>1.4 issuance and sale of shares.</li> </ul> <p>2. Investments in existing units shall be governed by equity participation.</p> <p>3. The Oversight Board of Trepça JSC may introduce contractual arrangements on governance and management in relevant business units even if the participation of private investors in equity is less than 50%.</p> <p>4. If the private investor's participation is higher than 50% in a business unit, the</p> | <p>1. Trepča AD će u okviru procesa transformacije i restrukturiranja u cilju stvaranja uslova za svoj razvoj, stvoriti mogućnosti da bude privlačna za domaće i strane privatne investitore, u sledećim formama:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>1.1 javno-privatno partnerstvo;</li> <li>1.2 direktne privatne investicije;</li> <li>1.3 zajedničke investicije;</li> <li>1.4 izdavanje i prodaja akcija.</li> </ul> <p>2. Investicijama u postojeće jedinice se upravlja prema udelu u kapitalu.</p> <p>3. Nadzorni odbor Trepče AD može da uspostavi ugovorne aranžmane za upravljanje i rukovođenje u odgovarajućim poslovnim jedinicama i onda kada je udeo privatnog investitora u kapitalu manji od 50%.</p> <p>4. U slučaju kada privatni investitor stvori udeo veći od 50% u poslovnoj jedinici,</p> |

|   |   |   |
|---|---|---|
| <p>biznesore, qeverisja dhe organizimi i entitetit biznesor bëhet sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare.</p> <p>5. Për investimet në metalurgji dhe në përpunim të metaleve si dhe në industrinë kimike, Qeveria e Republikës së Kosovës, si aksionari kryesor, dhe investitorët privatë mund të formojnë kompani që mbetet në një aleancë dhe partneritet strategjik me Trepça Sh.A. Partneriteti strategjik ndërtohet për bashkëpunim afarist lidhur me furnizimin me koncentrat të mineraleve të eksploatuara nga njësitë përkatëse të Trepça Sh.A.</p> <p>6. Në bazë të studimit të fizibilitetit, partneriteti strategjik mund të lidhet në interes për zhvillimin e metalurgjisë, përpunim të metaleve në Kosovë dhe gjithashtu edhe për shfrytëzim të metaleve të rralla e të çmuara, zhvillim të industrisë kimike dhe produkte e shërbime të tjera që gjenerojnë punësim në Kosovë.</p> <p>7. Trepça Sh.A. mund të regjistrohet në bursat e tregut të letrave me vlerë me qëllim të sigurimit të burimeve për investime të reja.</p> | <p>governance and organization of the business entity shall be done in line with the applicable legislation on corporations.</p> <p>5. For investments in metallurgy, metal processing and chemical industry, the Government of the Republic of Kosovo, as the main shareholder, and private investors may establish companies that rely on an alliance and strategic partnership in Trepça JSC. The strategic partnership shall be developed for business cooperation regarding the supply of concentrate minerals exploited by relevant units of Trepça JSC.</p> <p>6. In accordance to a feasibility study, the strategic partnership may be concluded in the interest of the development of metallurgy, metal processing in Kosovo as well as for the exploitation of rare and precious metal, development of the chemical industry and other products and services that generate employment in Kosovo.</p> <p>7. Trepça JSC may be listed in the securities market in order to secure resources for new investments.</p> | <p>upravljanje i organizacija poslovnog subjekta se vrši u skladu sa važećim propisima o poslovnim društvima.</p> <p>5. Radi investicija u metalurgiju i preradu metala, kao i u hemijsku industriju, Vlada Republike Kosovo, kao glavni akcionar i privatni investitori mogu osnovati kompaniju koja ostaje u strateškoj alijansi i strateškom partnerstvu sa Trepčom AD. Strateško partnerstvo se gradi u cilju poslovne saradnje u pogledu snabdevanja koncentratima minerala koje eksploatišu odgovarajuće jedinice Trepče AD.</p> <p>6. Na osnovu studije o izvodljivosti, strateško partnerstvo se može sklopiti u interesu razvoja metalurgije, prerade metala na Kosovu, kao i radi eksploatacije retkih i dragocenih metala, razvoja hemijske industrije i drugih proizvoda i usluga koji generišu zapošljavanje na Kosovu.</p> <p>7. Trepča AD se može registrovati na berzama tržišta hartija od vrednosti u cilju obezbeđivanja izvora za nove investicije.</p> |
|---|---|---|

|   |  |   |
|---|--|---|
| <p><b>KAPITULLI VI - PËRGJEGJËSIA SOCIALE DHE RAPORTI ME KOMUNITETIN</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13</b></p> <p>1. Trepça Sh.A. dhe njësitë e saj do të qeverisen me parimin e përgjegjësisë sociale duke i kontribuar zhvillimit të komunitetit.</p> <p>2. Pas inkasimit të rentës minerale nga institucioni përkatës, 20% e vlerës së kësaj rente rialokohet nga Buxheti Qendror për Buxhetin Komunal të Komunës ku ndodhet njësia biznesore, e dedikuar në mënyrë specifike për investime në zhvillimin e komunitetit në lokacionin ku ndodhet njësia biznesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, infrastrukturës, sport, shëndetësi dhe arsim.</p> | <p><b>CHAPTER VI - SOCIAL RESPONSIBILITY AND RELATIONS WITH THE COMMUNITY</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13</b></p> <p>1. Trepça JSC and its units shall be governed by the principle of social responsibility, contributing to community development.</p> <p>2. After collection of mining royalty by the relevant institution, 20% of the value of such royalty shall be reallocated from the Central budget to the Municipal Budget of the Municipality where the business unit is located, dedicated specifically for investments in community development in the location in which the business unit is located, in the field of environment protection, infrastructure, sports, healthcare and education.</p> | <p><b>POGLAVLJE VI - DRUŠTVENA ODGOVORNOST I ODNOS SA ZAJEDNICOM</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13</b></p> <p>1. Trepčom AD i njenim jedicama će se upravljati po principu društvene odgovornosti uz pružanje doprinosa razvoju zajednice.</p> <p>2. Nakon naplate rudne rente od strane nadležne institucije, 20% vrednosti te rente će se iz Centralnog budžeta preusmeriti za opštinski budžet opštine u kojoj se nalazi poslovna jedinica i biće konkretno namenjena za investicije u razvoj zajednice na lokaciji na kojoj se nalazi poslovna jedinica u oblasti zaštite životne sredine, infrastrukture, sporta, zdravstva i obrazovanja.</p> |
| <p><b>KAPITULLI VII - PJEŠËT TJERA TË NSH “TREPÇA”</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b></p> <p>Asetet tjera të ndërmarrjes shoqërore “Trepça”, të cilat nuk transformohen me</p>   | <p><b>CHAPTER VII - OTHER PARTS OF “TREPÇA” SOE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b></p> <p>Other assets of the socially owned enterprise “Trepça”, which are not transformed in</p>   | <p><b>POGLAVLJE VII - OSTALI DELOVI DP „TREPČA“</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b></p> <p>Ostala sredstva društvenog preduzeća „Trepča“, koje se ne transformišu ovim</p>  |



|  |   |  |
|--|---|--|
| <p>këtë ligj në Trepça Sh.A., do të trajtohen sipas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit. Asetet jothelbësore dhe joprofitabile do të mbeten në menaxhim të AKP-së për t’iu nënshkruar privatizimit ose likuidimit në përputhje me ligjin.</p> <p><b>KAPITULLI VIII - PRETENDIMET E KREDITORËVE</b></p> <p><b>Neni 15</b></p> <p>1. Pretendimet kreditore ndaj njësive biznesore sipas nenit 2 të këtij ligji, të krijuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në cilësinë e administratorit dhe nga Dhoma e Posaçme.</p> <p>2. Të gjitha detyrimet e vërtetuara me vendim të plotfuqishëm të Dhomës së Posaçme lidhur me pretendimet kreditore ndaj këtyre njësive biznesore, kompensohen sipas legjislacionit në fuqi për ndërmarrjet shoqërore në Republikën e Kosovës.</p> | <p>accordance with this law into Trepça JSC shall be treated as per the recommendations of the feasibility study. Non-core and unprofitable asset shall remain under KPA management, in order to be subjected to privatization of liquidation, in accordance with the law.</p> <p><b>CHAPTER VIII - CREDITOR CLAIMS</b></p> <p><b>Article 15</b></p> <p>1. Creditor claims against business units stipulated in Article 2 of this Law, established up to the day of entry into force of this law, shall be addressed by the Kosovo Privatization Agency in its administrator capacity, and by the Special Chamber.</p> <p>2. All liabilities verified by means of a final decision of the Special Chamber related to creditor claims against these business units, shall be compensated in accordance with the law on socially-owned enterprises in the Republic of Kosovo.</p> | <p>zakonom u Trepča AD, tretiraće se u skladu sa preporukama iz studije o izvodljivosti. Nebitna i neprofitabilna sredstva će ostati pod upravom KAP sa ciljem da se podvrgnu privatizaciji ili likvidaciji u skladu sa zakonom.</p> <p><b>POGLAVLJE VIII - POTRAŽIVANJA POVERILACA</b></p> <p><b>Član 15</b></p> <p>1. Poverilačka potraživanja od organizacionih jedinica iz člana 2. ovog zakona, nastala do dana stupanja na snagu ovog zakona razmatraju se od strane Kosovske Agencije za privatizaciju u svojstvu administratora i Posebne komore.</p> <p>2. Sve obaveze utvrđene pravosnažnom odlukom Posebne komore koje se odnose na poverilačka potraživanja od ovih organizacionih jedinica, biće nadoknađene u skladu sa važećim propisima o društvenim preduzećima u Republici Kosovo.</p> |
|--|---|--|

| <p align="center"><b>KAPITULLI IX - DISPOZITAT<br/>KALIMTARE DHE<br/>PËRFUNDIMTARE</b></p>   | <p align="center"><b>CHAPTER IX - TRANSITIONAL AND<br/>FINAL PROVISIONS</b></p>   | <p align="center"><b>POGLAVLJE IX - PRELAZNE I<br/>KONAČNE ODREDBE</b></p>   |
|--|---|--|
| <p align="center"><b>Neni 16</b></p> <p>Në qoftë se para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë filluar procedura të riorganizimit, falimentimit apo likuidimit, lidhur me njësitë organizative të NSH. “Trepça” nga neni 2 i këtij ligji, ato ndërpriten me hyrjen në fuqi të këtij ligji.</p> | <p align="center"><b>Article 16</b></p> <p>In the event that prior to the entry into force of this law, a reorganizational, bankruptcy or liquidation procedure has been initiated for the organizational units of Trepça SOE stipulated in Article 2 of this law, such procedures shall be terminated upon entry into force of this law.</p> | <p align="center"><b>Član 16</b></p> <p>Ako su pre stupanja na snagu ovog zakona pokrenute procedure reorganizacije, stečaja ili likvidacije koje se odnose na organizacione jedinice DP „Trepča“ iz člana 2 ovog zakona, iste se obustavljaju po stupanju na snagu ovog zakona.</p> |
| <p align="center"><b>Neni 17</b></p> <p>Dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë mbi çdo dispozitë tjetër të legjislacionit tjetër që mund të parasheh diçka ndryshe prej asaj që parashihet me këtë ligj.</p>  | <p align="center"><b>Article 17</b></p> <p>Provisions of this law shall supersede any provision of other laws which may envisage a different regulation to that established by this law.</p>  | <p align="center"><b>Član 17</b></p> <p>Odredbe ovog zakona imaju premoć nad svakom drugom odredbom ostalih propisa, koja može propisivati nešto drugačije od onoga što je propisano ovim zakonom.</p>   |
| <p align="center"><b>Neni 18</b></p> <p>Qeveria, me propozimin e Ministrisë, miraton aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda një (1) viti nga hyrja e tij në fuqi.</p>  | <p align="center"><b>Article 18</b></p> <p>The Government, at the Ministry’s proposal, adopts subsidiary legislation required to implement this law, within one (1) year from its entry into force.</p>   | <p align="center"><b>Član 18</b></p> <p>Vlada, na predlog Ministarstva, usvaja podzakonske akte za sprovođenje ovog zakona u roku od jedne (1) godine od dana njegovog stupanja na snagu.</p>  |

| <b>Neni 19</b>  | <b>Article 19</b>   | <b>Član 19</b>  |
|---|---|---|
| <p data-bbox="201 269 753 337">Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p data-bbox="590 526 753 553" style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr data-bbox="338 623 753 626" style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p data-bbox="296 708 753 776" style="text-align: center;">Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p> | <p data-bbox="779 269 1362 375">This law shall enter into force the day it is published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p data-bbox="1199 526 1362 553" style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr data-bbox="947 623 1362 626" style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p data-bbox="785 708 1362 776" style="text-align: center;">President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p> | <p data-bbox="1388 269 1923 375">Ovaj zakon stupa na snagu danom objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p data-bbox="1761 526 1923 553" style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <hr data-bbox="1509 623 1923 626" style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p data-bbox="1394 708 1923 740" style="text-align: center;">Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p> |